



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

AKT-MIRATIMI

ORGAN I MIRATUAR

I VLERËSIM KONFORMITETIT.

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit”” edhe në Çertifikatën e Akreditimit me Nr. **TI 028** Regjistrimi,

MIRATOJ:

Subjekti:	“TIGO 2008” shpk.
Me Administrator:	Genti ÇEKAJ
Me Drejtues Teknik:	Lutfi ÇEKAJ
Adresa e subjektit:	Lagjia “Salo Halili” Rruga “Mbreti Gent” Kompleksi “Uraj” Shkodër
Tel.:	-
Cel.:	069 23 17 514
E-mail:	lutficekaj@hotmail.com
të ushtrojë veprimtarinë si Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK):	
Tipi i OMVK-së:	Tipi A
Fusha e Veprimtarisë:	1. Inspektimi i rezervuareve të GLN me kapacitet më të vogël ose të barabartë me 13 m³. 2. Inspektimi i rezervuareve të GLN me kapacitet më të madh se 13 m³, mbi tokë. 3. Tubacionet nën presion, - Aksesorët e sigurisë dhe aksesorët nën presion. 4. Pajisjet nën presion me vatra zjarri. - Kaldajat e avullit dhe ujit të nxehtë.

	5. Çisternat automobilistike të transportit të mallrave të rrezikshëm, - Klasa 2 ADR: gaze të ngjeshura, të lëngëzuara ose të tretur në presion, - Klasa 3 ADR: lëngje të djegshme
Rregullat teknike/ standardet e sigurisë së produktit/pajisjes/instali mit të vënë në shërbim:	1. VKM Nr.1062, date 23.12.2015, "Per pajisjet dhe bashkësite nën presion dhe përcaktimin e standardeve të harmonizuara "(aneksi V). 2. Standardi S SH EN 12817:2010 "Pajisjet dhe aksesoret për GLN. Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuareve të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) më të vogël ose të barabartë me 13 m ³ ". 3. Standardi S SH EN 13175:2014 "Specifikimi dhe provat për ventilët dhe paisjet e rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN). 4. Standardi S SH EN 12819:2009 "Pajisjet dhe aksesoret për GLN. Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuareve të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) më të madh se 13 m ³ ". 5. Ligji Nr.32/2016 date 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së pajisjeve e instalimeve nën presion". 6. VKM nr. 1065, datë 23.12.2015, "Enë të thjeshta nën presion dhe përcaktimin e standardeve të harmonizuara". 7. Ligji Nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore". 8. Standardi S SH EN 13480-5: 2012+A1:2013 "Tuba metalikë për industrinë"-Pjesa 5: Inspektimi dhe prova. 9. Metodë jostandarde, Rregullore e shfrytëzimit të kaldajave me avull" viti 1984. 10. Ligji nr. 9772, datë 16.09.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Evropiane për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR) dhe protokollin e nënshkrimit". 11. S SH EN 12972-2015 "Çisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme - Provat, inspektimi dhe marketimi i çisternave metalike".
Periudha e vlefshmërisë:	Deri më 05.02.2022
Territori i ushtrimit të veprimtarisë:	Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Personi përgjegjës firmosës:	Genti Çekaj dhe Lutfi Çekaj
Nr. Telefoni:	069 23 17 514
E-mail:	genti25cekaj@gmail.com dhe lutficekaj@hotmail.com
OMVK regjistrohët me Nr. Identifikimi:	OMI 0 0 6 Rishikim 0
OMVK detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kërkesat dhe kushtet sa më poshtë: 1. Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit të tij të miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese. 2. Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij	

të gjykimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;

3. Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;
4. I siguron Ministrin, Strukturës Administrative Përgjegjëse (SAP)), brenda 10 ditësh, kopje të certifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e certifikatave për çdo subjekt;
5. Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paaftë të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;
6. Informon brenda 5 ditësh Ministrin (SAP) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje certifikate;
7. Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në vartësi të MIE-s për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;
8. Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo me pak se 10 vjet.
9. Me kërkesë të ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testime ose krahasime të tjera të përcaktuara për OMVK-të.
10. Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet ti dërgojë Ministrin (SAP) regjistrin e inspektimeve ose certifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë.
11. Organi i Miratuar detyrohet t'u krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrin, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në të gjitha ambjentet ku OMVK ka kryer vlerësimi të konformitetit, të përcaktuar në miratimin e lëshuar.

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më, një apo disa kritere a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim/në përdorim dhe kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit, SAP i propozon Ministrin pezullimin e Aktit të Miratimit deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre.

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, SAP përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrin urdhërin për shfuqizimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 03 / 05 /2018

MINISTRI

Damian Gjikhuri